

VENDIM
Nr. 384, datë 29.6.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “REHABILITIMI I RRUGËS SË ISH-REPARTIT USHTARAK PËR NË AEROPORTIN E RINASIT”

(Ndryshuar me VKM nr. 381¹, datë 10.7.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të *pronarëve të pasurisë së paluajtshme*, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i rrugës së ish-repartit ushtarak për në Aeroportin e Rinasit”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. *Pronarët e pasurive të paluajtshme*, pronë private, që shpronësohen, kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 482 432 (një milion e katërqind e tetëdhjetë e dy mijë e katërqind e tridhjetë e dy) lekësh.

4. *Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 482 432 (një milion e katërqind e tetëdhjetë e dy e mijë e katërqind e tridhjetë e dy) lekësh përballohet, si më poshtë vijon:*

a) vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 477 120 (katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet) lekësh përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar;

b) vlera shtesë prej 1 005 312 (një milion e pesë mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekësh përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoritetit Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. *Pronarëve të pasurisë së paluajtshme*, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar kryen procedurat për likuidimin e *pronarëve të shpronësuar*, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë - Vorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

¹ VKM nr. 381, datë 10.7.2025 në pikën 2 dhe 4 shprehet;

“2. Bashkëpronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën shtesë që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.”

“4. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.”

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë - Vorë, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrotjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARIT, PASURIA E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE E TË CILIT SHPRONËSOHET, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTI "REHABILITIMI I RRUGËS SË ISH-REPARTIT USHTARAK PËR NË AEROPORTIN E RINASIT"

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Sip. totale m ²	Lloji i pasurisë	TOKE ARË			VLERA TOTALE (LEK)	ADRESA	SHËNIME
								Sip. e shpronësuar	Çmimi (lek/m ²)	Vlera lek			
1	Skënder	Sinan	Kulli	1669	42/69	3150	Arë	1065	448	477120	477,120.00	Tiranë (Fushë-Prezë)	Konfirmuar nga ASHK-ja Në favor të BKT-së. Kontratë hipotekare nr. 1925/1016, datë 26.12.2018
Vlera totale								1065	448	477120	477,120.00		

(Shtuar tabela me VKM nr. 381, datë 10.7.2025)

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURIA E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE E TË CILËVE SHPRONËSOHET, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTI "REHABILITIMI I RRUGËS SË ISH-REPARTIT USHTARAK PËR NË AEROPORTIN E RINASIT"

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri pasurisë	Sip. Total e m ²	Lloji pasurisë	TOKE ARË			VLERA TOTALE (LEKË)	ADRESA	SHËNIME
								Sip. e shpronësuar	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera lekë			
2	Balfin Construction, Blendi Hektor Fevzi			1669	241/6	89177.2	Arë	2244	448	1005312	1,005,312.00	Tiranë (Fushë-Prezë)	
Vlera totale								2244	448	1005312	1,005,312.00		